



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 78/2020

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për
 - a) organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës;
 - b) zbatimin e vendimeve gjyqësore penale dhe urdhërimeve të prokurorit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, të masave të shmangies nga ndjekja penale, të dënimeve jo me burgim për të miturit, ose veprimtari të tjera sipas akteve të tjera ligjore në fuqi;
 - c) trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit nën mbikëqyrje për të siguruar përshtatjen dhe riintegrimin e tij në shoqëri;
 - ç) zbatimin e detyrimeve të personave nën mbikëqyrje gjatë kohës së vënies në provë.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për vendimet gjyqësore penale të dhëna nga gjykatat vendase dhe të huaja në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të mundësojë rehabilitimin dhe riintegrimin shoqëror të personave nën mbikëqyrje, parandalimin e veprave penale dhe uljen e rrezikut të përsëritjes së tyre, uljen e kostove sociale, si dhe të kontribuojë në mbrojtjen e interesit publik.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dënime alternative” janë alternativat e dënimit me burgim, që mund të vendosen nga gjykata sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. “Dënime jo me burgim për të miturit” janë dënimet e parashikuara në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

3. “Drejtësi restauruese” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

4. “I mbikëqyrur i mitur” është çdo person nën moshën 18 vjeç, që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe ndaj të cilit organi kompetent i sistemit të drejtësisë penale për të mitur ka dhënë një masë alternative apo dënim jo me burgim.

5. “Masa alternative” janë masat për shmangien nga ndjekja penale, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, si dhe masat shtrënguese me mbikëqyrje elektronike, sipas legjislacionit në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet liria me vendim gjyqësor.

6. “Mbikëqyrje” janë aktivitetet që kryhen nga Shërbimi i Provës për zbatimin e masave alternative dhe dënimeve alternative, si dhe urdhërimeve të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, me qëllim mbështetjen, këshillimin dhe riintegrimin në shoqëri të personit nën mbikëqyrje.

7. “Person nën mbikëqyrje” është:

a) i dënuari ndaj të cilit gjykata me vendim gjyqësor ka vendosur një prej alternativave të dënimit me burgim; ose

b) personi ndaj të cilit gjykata ka vendosur një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, sipas legjislacionit në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, vetëm kur gjykata ka vendosur që personi të jetë nën mbikëqyrje elektronike; ose

c) personi ndaj të cilit është caktuar me vendim gjyqësor ndonjë masë tjetër shtrënguese, e parashikuar me ligje të veçanta.

8. “Përkujdesje e mëtejshme” është procesi i planifikuar nga Shërbimi i Provës në bashkëpunim me personin nën mbikëqyrje dhe me pëlqimin e tij për t’u zhvilluar edhe pas mbikëqyrjes së ekzekutimit të të gjitha detyrimeve të vendosura ndaj tij, me qëllim riintegrimin e tij në shoqëri.

9. “Shmangie” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

10. “Specialist i Shërbimit të Provës” është punonjësi i ngarkuar për mbikëqyrjen dhe asistimin e personit nën mbikëqyrje gjatë zbatimit të alternativave të dënimit me burgim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. “Vënia në provë” është plotësimi i kushteve të caktuara nga organi procedues ndaj personit të vendosur nën mbikëqyrje për një periudhë të caktuar kohore. Vënia në provë përfshin një sërë aktivitetesh dhe ndërhyrjesh, të tilla si: kontrollin, këshillimin, orientimin dhe asistencën në zhvillimin e aftësive dhe mundësive për punësim, si dhe trajtimin me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri të personit nën mbikëqyrje.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë së Shërbimit të Provës

1. Veprimtaria e Shërbimit të Provës realizohet në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) ligjshmëria në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

b) proporcionaliteti në mënyrë që ndërhyrjet e Shërbimit të Provës të jenë të nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj dhe në vendimin gjyqësor, mjetet dhe masat e përdorura të kufizojnë sa më pak të drejtat e personit nën mbikëqyrje dhe familjes së tij dhe të jenë në proporcion me nevojën që ka diktuar vendosjen e tyre.

c) barazia dhe mosdiskriminimi për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

ç) transparenca dhe komunikimi në një gjuhë të kuptueshme përmes një përkthyesi zyrtar, nëse personi nuk flet apo nuk kupton gjuhën shqipe dhe në mënyrë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, sipas standardeve dhe legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

d) respektimi i jetës private të personit nën mbikëqyrje dhe familjes së tij, duke e kufizuar atë vetëm kur është e nevojshme për mbrojtjen e interesit publik, ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave të tjerë.

dh) ruajtja e konfidencialitetit për informacionin e krijuar dhe të administruar për shkak të funksionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

e) kontrolli dhe llogaridhënia.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Shërbimi i Provës garanton respektimin e standardeve të larta etike, të integritetit, meritës dhe profesionalizmit, si dhe respekton dinjitetin dhe integritetin e personit nën mbikëqyrje të familjes së tij, të viktimës së veprës penale dhe të familjes së saj.

3. Shërbimi i Provës mbështet zhvillimin e marrëdhënieve pozitive ndërmjet specialistit të Shërbimit të Provës dhe personit nën mbikëqyrje dhe për aq sa është e mundur kërkon pëlqimin dhe bashkëpunimin e personave nën mbikëqyrje për ndërhyrjet që prekin ato.

Neni 5

Misioni i Shërbimit të Provës

Misioni i Shërbimit të Provës është promovimi i përfshirjes shoqërore të personave nën mbikëqyrje, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe zhvillimin e ndjenjës së

përgjegjësisë ndaj shoqërisë dhe viktimës nëpërmjet rregullave të ndërveprimit social dhe ndërhyrjeve të posaçme.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 6

Organizimi i Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës është person juridik publik, me seli në Tiranë, që ushtron veprimtarinë e tij në varësi të ministrit të Drejtësisë.

2. Shërbimi i Provës financohet nga buxheti i shtetit dhe buxheti i tij miratohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

3. Shërbimi i Provës organizohet në:

a) nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës;

b) nivel vendor nëpërmjet degëve territoriale të Shërbimit të Provës.

4. Struktura dhe organika e Shërbimit të Provës miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

5. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Shërbimit të Provës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

6. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale rregullohen sipas Kodit të Punës.

7. Rregullat e detajuara për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit të Provës përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

Funksionet e Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës ushtron funksionet e mëposhtme:

a) mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve alternative ndaj personave nën mbikëqyrje në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe urdhrit të ekzekutimit të prokurorit, ku përfshihet edhe mbikëqyrja e të:

i) dënuarit të varur nga droga ose alkooli, i cili i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm rehabilitues;

ii) dënuarit të liruar me kusht;

b) harton dhe mbikëqyr mënyrën e zbatimit të planit individual të trajtimit të personit nën mbikëqyrje, duke marrë për bazë risqet dhe nevojat për rehabilitimin dhe riintegrimin e tij shoqëror;

c) mbështet personin nën mbikëqyrje për kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror gjatë dhe pas përfundimit të periudhës së provës.

ç) adreson problematikat për punësim, strehim, arsimim, kualifikim dhe nevojat për mbrojtje sociale të personit nën mbikëqyrje, në mënyrë që të reduktohet në të ardhmen rreziku i recidivizmit dhe të mundësohet riintegrimi i tij në shoqëri;

d) harton raporte vlerësimi dhe/ose raporton pranë prokurorisë dhe gjykatës në përputhje me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe aktet e tjera ligjore apo nënligjore në fuqi;

dh) mbledh në mënyrë sistematike të dhëna rreth veprimtarisë me personat nën mbikëqyrje;

e) mbështet përmirësimin e praktikës së punës me personat nën mbikëqyrje.

2. Shërbimi i Provës ofron shërbime të aksesueshme për personat nën mbikëqyrje me shtetësi të huaj ose personat pa shtetësi të dënuar nga gjykatat shqiptare.

Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës bashkëpunon me agjencitë dhe institucionet e shërbimit të provës në vendet e origjinës së shtetasve të huaj nën mbikëqyrje në zbatim të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, për të lehtësuar sistemimet e nevojshme mbikëqyrëse gjatë kthimit të këtyre personave në vendin e origjinës.

Neni 8

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës është përgjegjëse për:

a) planifikimin dhe drejtimin strategjik të veprimtarisë së Shërbimit të Provës;

b) paraqitjen pranë ministrit të Drejtësisë të raporteve periodike për zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi;

c) organizimin, drejtimin e koordinimin e procesit të mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative dhe masave alternative nga degët territoriale;

ç) ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur të lidhura me fushën e përgjegjësisë së Shërbimit të Provës;

d) organizimin, drejtimin dhe koordinimin e procesit të mbikëqyrjes elektronike, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor;

dh) kryerjen e studimeve e të analizave të nevojshme për përgatitjen e dokumenteve strategjike në fushën e shërbimit të provës dhe hartimin e politikave penale e shoqërore;

e) koordinimin dhe përgatitjen e standardeve, metodologjisë së punës, me qëllim unifikimin e praktikës dhe përmirësimin e veprimtarisë së specialistëve të Shërbimit të Provës;

ë) vlerësimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e veprimtarisë së zhvilluar nga degët territoriale të Shërbimit të Provës;

f) koordinimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore të Shërbimit të Provës në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e Shërbimit të Provës;

g) ndjekjen e trajnimit profesional të specialistëve të Shërbimit të Provës në bashkëpunim me institucione, donatorë ose organizata vendase ose të huaja;

gj) përfaqësimin në proceset gjyqësore, ku Shërbimi i Provës është palë;

h) krijimin, mbajtjen, përditësimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore në fushën e Shërbimit të Provës;

i) rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe institucioneve për rolin dhe veprimtarinë e Shërbimit të Provës;

- j) administrimin financiar të institucionit të Shërbimit të Provës;
 - k) lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ose memorandumeve të mirëkuptimit me autoritete të tjera brenda dhe jashtë vendit për qëllime të zbatimit të këtij ligji;
 - 1) kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi.
2. Rregullorja e brendshme e Shërbimit të Provës miratohet nga ministri i Drejtësisë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

Neni 9

Kompetenca tokësore e degëve territoriale

1. Dega territoriale, ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin personi nën mbikëqyrje, është kompetente për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim, të caktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe për realizimin e mbikëqyrjes në territorin e vet të kompetencës.
2. Dega territoriale, ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin personi subjekt vlerësimi, është kompetente për hartimin e raportit të vlerësimit. Nëse personi që vlerësohet ndodhet në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, kompetente është dega territoriale ku ndodhet institucioni ku kryhet dënimi me burgim. Në raste të veçanta, në mbledhjen e informacionit për hartimin e raportit të vlerësimit mund të bashkëpunojnë edhe degë të tjera territoriale.
3. Në rast konflikti kompetence ndërmjet degëve territoriale, zgjidhja e konfliktit bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni për këtë konflikt.

Neni 10

Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës në marrëdhënie me të tretët, organizon dhe kontrollon veprimtarinë e saj dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Drejtësisë.
3. Kandidati për drejtor të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë përfunduar të paktën ciklin e dytë të studimeve universitare në degët: psikologji, drejtësi, punë sociale ose sociologji ose diplomë të njësuar me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;
 - c) të ketë përvojë pune jo më pak se 10 vjet në profesion, nga të cilat të paktën 5 vjetët e fundit të jetë angazhuar në fushën e të drejtave të njeriut ose të shërbimeve në komunitet;
 - ç) të mos ketë qenë i dënuar për një vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) ndaj tij të mos jetë marrë më parë masa disiplinore e largimit nga detyra ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - dh) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale.

Neni 11

Drejtori i degës territoriale

1. Drejtori i degës territoriale është përgjegjës për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e përmbushjes së detyrave nga specialistët e degës territoriale të Shërbimit të Provës.

2. Drejtori i degës territoriale të Shërbimit të Provës emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra në përputhje me legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

3. Përveç kriterëve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, drejtori i degës territoriale të Shërbimit të Provës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar të paktën ciklin e dytë të studimeve universitare në degët: psikologji, drejtësi, punë sociale ose sociologji apo diplomë të njësuar me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në profesion.

Neni 12

Specialisti i Shërbimit të Provës

1. Specialisti i Shërbimit të Provës emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra në përputhje me legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

2. Përveç kriterëve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil, specialisti i Shërbimit të Provës duhet të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në degët: psikologji, drejtësi, punë sociale ose sociologji apo diplomë të njësuar me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë përvojë pune jo më pak se 1 vit në profesion.

3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, specialisti i Shërbimit të Provës udhëhiqet nga parimet e paanësisë, profesionalizmit dhe ruajtjes së integritetit profesional dhe etiko-moral.

4. Specialisti i Shërbimit të Provës nuk mund të kryejë funksione dhe detyra të tjera publike apo private, të cilat bien ndesh me detyrat e tij funksionale dhe ligjore, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademike dhe shkencore.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrimet e specialistëve të Shërbimit të Provës

1. Specialisti i Shërbimit të Provës është përgjegjës për:

a) mbikëqyrjen e masave alternative, dënimeve jo me burgim, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, alternativave të dënimit me burgim sipas Kodit Penal, si dhe masave të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta;

b) hartimin e raporteve të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje për t'ua paraqitur prokurorisë dhe gjykatës, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;

c) asistimin, këshillimin dhe riintegrimin në shoqëri të personit nën mbikëqyrje.

2. Për aq sa është e nevojshme për kryerjen e detyrave funksionale, specialisti i Shërbimit të Provës ka të drejtë:

a) gjatë procedimit penal të njihet me të dhëna të përgjithshme për subjektin e vlerësimit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale prej tij, që nuk përbëjnë sekret hetimor apo konfidencial dhe gjatë procesit gjyqësor të njihet me informacionin e administruar në dosjen e gjykimit, në përputhje me kërkesat dhe afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale;

b) të njihet me informacionin e administruar nga institucionet e tjera shtetërore, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 14

Konflikti i interesit

1. Specialisti i Shërbimit të Provës ka detyrimin të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në kryerjen e detyrës.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës, gjatë kryerjes së detyrave të tij për mbikëqyrjen dhe asistimin e personit nën mbikëqyrje, deklaron të gjitha rastet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

3. Specialisti i Shërbimit të Provës është i detyruar të kërkojë menjëherë heqjen dorë nga mbikëqyrja dhe asistimi i personit nën mbikëqyrje në rastet e konfliktit faktik e të vazhdueshëm të interesit me të.

4. Deklarimi i konfliktit të interesit dhe kërkesa për heqjen dorë i paraqiten për vendimmarrje drejtorit të degës përkatëse territoriale të Shërbimit të Provës. Në rastet kur konflikti i interesit deklarohet nga drejtori i degës territoriale përkatëse ose nga çdo person i interesuar, aktet i paraqiten për vendimmarrje drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës. Përmbajtja e kërkesës dhe e vendimit u njoftohet palëve menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se tre ditë nga marrja e vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 15

Sistemi i trajnimit profesional të specialistëve të Shërbimit të Provës

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës përgjigjet për hartimin dhe zhvillimin e strategjisë së trajnimit profesional të specialistëve të Shërbimit të Provës për përmirësimin e rolit të tyre dhe të nivelit të përgjegjësiwe profesionale.

2. Programi i trajnimeve hartohet në dy drejtime kryesore:

a) trajnimi fillestar, që organizohet për specialistët e Shërbimit të Provës në periudhë prove;

b) trajnimi vazhdues, që organizohet për specialistët e Shërbimit të Provës të konfirmuar në detyrë, në përfundim të periudhës së provës.

3. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, sipas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, organizon trajnime për tematika që lidhen me mbikëqyrjen e masave alternative, alternativave të dënimit me burgim, si dhe asistimin dhe rehabilitimin e personave nën mbikëqyrje.

4. Trajnimet sipas tematikave të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, mund të organizohen edhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës ose me organizata dhe agjenci vendase ose të huaja të akredituara për të ofruar trajnime.

Neni 16

Trajnimi fillestar

1. Trajnimi fillestar synon aftësimin e specialistëve të Shërbimit të Provës në periudhë prove, me njohuritë e duhura profesionale teorike dhe praktike, për mbikëqyrjen e masave alternative, dënimeve jo me burgim, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, alternativave të dënimit me burgim sipas Kodit Penal, si dhe asistimin dhe riintegrimin në shoqëri të personave nën mbikëqyrje.

2. Programi i trajnimit fillestar përcakton rregullat dhe kushtet për modulet ose kurset e trajnimit, kontrollin e njohurive në përfundim të trajnimit fillestar, si dhe për lëshimin e certifikatës për përfundimin me sukses të programit të trajnimit fillestar.

3. Programi i trajnimit fillestar hartohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 17

Trajnimi vazhdues

1. Programi i trajnimit vazhdues synon përditësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të specialistëve të Shërbimit të Provës me njohuri specifike profesionale teorike dhe praktike, për t'iu përshtatur zhvillimeve të kuadrit ligjor dhe standardeve ndërkombëtare.

2. Ndjekja e programit të trajnimit vazhdues është e detyrueshme dhe në përfundim të përmbushjes së detyrimit specialisti i Shërbimit të Provës pajiset me certifikatën përkatëse.

3. Specialistët e Shërbimit të Provës, të ngarkuar me mbikëqyrjen e të miturve në konflikt me ligjin, i nënshtrohen trajnimit vazhdues të specializuar për drejtësinë penale për të mitur, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

4. Specialistët e Shërbimit të Provës, të ngarkuar me mbikëqyrjen e personave me aftësi të kufizuara, personave vulnerabël ose me nevoja të veçanta, u nënshtrohen programeve të specializuara të trajnimit vazhdues.

5. Programi i trajnimit vazhdues përcakton metodat e trajnimit, programin dhe modulet e trajnimit, rregullat dhe kushtet për lëshimin e certifikatave të pjesëmarrjes.

6. Programi i trajnimit vazhdues hartohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

KREU III

MBËSHTETJA E SHËRBIMIT TË PROVËS GJATË PROCESIT GJYQËSOR

Neni 18

Detyrimi për të paraqitur raport vlerësimi

1. Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës, paraqet jo më vonë se 14 ditë nga marrja e kërkesës, raportin e vlerësimit për të miturin në konflikt me ligjin, personin nën hetim, të pandehurin ose personin nën mbikëqyrje:

- a) gjatë fazës së hetimeve paraprake;
 - b) përpara dhënies së masës alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe në përfundim të ekzekutimit të saj;
 - c) gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit penal;
 - ç) gjatë fazës së ekzekutimit në rastet e:
 - i. mbikëqyrjes së të dënuarit të vënë në provë;
 - ii. shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;
 - iii. përfundimit para kohe të periudhës së vënies në provë;
 - iv. përfundimit të dënimit alternativ apo përfundimit të përmbushjes së detyrimeve të caktuara;
 - v. mospërmbushjes së detyrimeve nga personi nën mbikëqyrje;
 - d) në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Raporti i vlerësimit paraqet të dhëna, që i vijnë në ndihmë prokurorit ose gjykatës në marrjen e vendimit në çdo fazë të procedimit penal, bazuar në informacione të detajuara dhe në analizën e rrethanave, shkaqeve të kryerjes së veprës penale dhe qëndrimeve të tij të paraqitura nga Shërbimi i Provës në mënyrë të qartë dhe të arsyetuar.
3. Specialisti i Shërbimit të Provës, i ngarkuar me mbikëqyrjen e personit nën mbikëqyrje, përveç raporteve të parashikuara në pikën 1, shkronja “ç”, të këtij neni, kryen kryesisht vlerësime dhe harton raporte periodike vlerësimi si dhe sa herë kërkohet nga prokurori dhe/ose gjykata, në varësi të periudhës së mbikëqyrjes, por në çdo rast jo më pak se një raport. Këto raporte vlerësimi përmbajnë informacion dhe rekomandime të arsyetuara për mënyrën e përmbushjes së detyrimeve të vendosura nga gjykata dhe sjelljen e personit nën mbikëqyrje, të cilat përfshihen në dosjen e Shërbimit të Provës. Një kopje e raportit të vlerësimit periodik vihet në dispozicion të personit nën mbikëqyrje, përfaqësuesit ose kujdestarit të tij ligjor dhe mbrojtësit.
4. Në përgatitjen e këtyre raporteve, specialisti i Shërbimit të Provës udhëhiqet nga parimi i profesionalizmit, mosdiskriminimit, objektivitetit dhe paanshmërisë.
5. Raportet e vlerësimit, të parashikuara në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, hartohen në përputhje me modelet standarde të miratuara me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

Neni 19

Raporti i Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës, në rast vlerësimi të të miturit, harton raportin e vlerësimit individual bazuar në parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.
2. Raporti i vlerësimit individual, në rastin e të miturit në konflikt me ligjin, përmban të dhëna për:
 - a) nivelin e zhvillimit psikologjik dhe mënyrën e jetesës së të miturit në konflikt me ligjin;
 - b) edukimin dhe arsimimin;
 - c) gjendjen shëndetësore;
 - ç) karakteristikat individuale të të miturit;

d) mjedisin familjar dhe social dhe kushtet e tjera të të miturit, të cilat e lejojnë për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të të miturit, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë së tij, të sjelljes dhe të nevojave të veçanta të tij;

dh) rrezikshmërinë për përsëritjen e veprës penale;

e) masat e duhura për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e tij në shoqëri;

ë) çdo e dhënë tjetër që vlerësohet e dobishme për qëllime të përgatitjes së raportit të vlerësimit.

3. Në përgatitjen e raportit të vlerësimit individual sipas pikës 2 të këtij neni, Shërbimi i Provës merr edhe mendimin e Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të juridiksionit ku ka vendbanimin i mituri.

4. Raporti i vlerësimit në rastin e personit nën hetim, të pandehurit ose të personit nën mbikëqyrje të rritur përmban të dhëna për:

a) gjendjen familjare;

b) mjedisin shoqëror të personit;

c) formimin arsimor e profesional dhe punësimin e mëparshëm;

ç) personalitetin, sjelljen e përgjithshme dhe analizën e sjelljes;

d) rrezikshmërinë për përsëritjen e veprës penale;

dh) sjelljen kundrejt viktimës së veprës penale dhe për zëvendësimin e dëmit të shkaktuar;

e) çdo e dhënë që vlerësohet si e dobishme për qëllime të përgatitjes së raportit të vlerësimit.

5. Gjatë kryerjes së vlerësimit individual, specialisti i Shërbimit të Provës takohet lirisht me të miturin në konflikt me ligjin ose me personin nën hetim, të pandehurin ose personin nën mbikëqyrje.

6. Çdo institucion shtetëror, ent publik ose subjekt privat bashkëpunon me Shërbimin e Provës dhe vendos në dispozicion të tij informacionin e nevojshëm për përgatitjen e raportit të vlerësimit në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni i posaçëm në fuqi.

7. Shërbimi i Provës raporton në mënyrë objektive dhe të paanshme, duke shmangur çdo ndikim, përfundimet që rezultojnë nga procesi i mbikëqyrjes. Raporti i vlerësimit individual nënshkruhet nga specialisti i Shërbimit të Provës dhe nga personi për të cilin hartohet raporti i vlerësimit, kur është e mundur, dhe, kur ky është i mitur, nënshkruhet nga kujdestari i tij ligjor dhe mbrojtësi. Një kopje e raportit të vlerësimit individual u vihet në dispozicion personit nën mbikëqyrje, kujdestarit të tij ligjor në rastin kur është i mitur dhe mbrojtësit.

8. Në rast pamundësie objektive për hartimin e raportit të vlerësimit, brenda afateve të përcaktuara nga prokuroria ose gjykata, ose kur për hartimin e raportit kërkohen të dhëna shtesë, që bëjnë të nevojshëm shtyrjen e afateve, Shërbimi i Provës njofton prokurorin ose gjykatën për pamundësinë e hartimit të raportit të vlerësimit në afatin e përcaktuar duke parashtruar edhe arsyet përkatëse. Në çdo rast Shërbimi i Provës harton raportin e vlerësimit jo më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit të arsyeve të shtyrjes.

9. Në përfundim të periudhës së mbikëqyrjes Shërbimi i Provës harton raportin përfundimtar, i cili përmban:

a) gjeneralitetet e personit nën mbikëqyrje;

b) të dhënat e vendimit gjyqësor penal, që ka caktuar dënimin ose masën alternative;

c) datën e fillimit dhe të përfundimit të dënimit ose masës alternative;

ç) arsyen e përfundimit të dënimit ose masës alternative; dhe

d) një paraqitje të ecurisë së përmbushjes së detyrimeve të dënimit ose masës alternative.

KREU IV

VEPRIMET E SHËRBIMIT TË PROVËS PËR MBIKËQYRJEN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE

Neni 20

Veprimet që kryhen në zbatim të urdhërimeve për mbikëqyrjen e dënimeve alternative

1. Veprimet që kryhen nga Shërbimi i Provës në zbatim të urdhrave të ekzekutimit, janë si më poshtë:

- a) verifikimi dhe përcaktimi i kompetencës territoriale;
- b) vendosja e kontaktit të parë dhe realizimi i intervistës me personin nën mbikëqyrje;
- c) informimi i personin nën mbikëqyrje për të drejtat dhe detyrimet që gëzon gjatë procesit të mbikëqyrjes;
- ç) hartimi i sistemit të vlerësimit të rrezikshmërisë;
- d) hartimi i planit individual të trajtimit në bashkëpunim me personin nën mbikëqyrje.

2. Rregullat e detajuara për procedurën e mbikëqyrjes së të dënuarve ndaj të cilëve janë vendosur dënimet alternative me gjysmëliri, pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, qëndrim në shtëpi, pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, lirim me kusht përcaktohen në legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 21

Veprimet përgatitore të Shërbimit të Provës

1. Drejtori i degës territoriale të Shërbimit të Provës, pas administrimit të urdhrimit të ekzekutimit, të nxjerrë nga prokurori sipas legjislacionit në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe verifikimit të kompetencës territoriale, cakton brenda 2 ditëve nga administrimi i urdhrimit të ekzekutimit, specialistin përgjegjës për mbikëqyrjen.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e administrimit të urdhrimit të ekzekutimit, verifikon përmbushjen vullnetare të detyrimit të personit nën mbikëqyrje për të vendosur kontakt me Shërbimin e Provës.

3. Në rastin kur personi nën mbikëqyrje, në përfundim të afatit 7-ditor nuk ka përmbushur vullnetarisht detyrimin për të vendosur kontaktin me Shërbimin e Provës, specialisti përgjegjës për mbikëqyrjen i njofton atij detyrimin për të vendosur kontakt. Në njoftim përcaktohen vendi dhe adresa e Shërbimit të Provës, data dhe ora e kontaktit, kontakti telefonik dhe elektronik i specialistit të Shërbimit të Provës përgjegjës për mbikëqyrjen, si dhe pasojat që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimit.

4. Njoftimi i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, realizohet nëpërmjet shërbimit postar. Për kryerjen e njoftimit, Shërbimi i Provës ka të drejtën e aksesit në bazat elektronike të adresave.

5. Në rast se personi nën mbikëqyrje nuk gjendet, Shërbimi i Provës njofton prokurorin, i cili vepron në përputhje me kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.

Neni 22

Vendosja e kontaktit të parë me Shërbimin e Provës

1. Personi nën mbikëqyrje vendos kontakt me specialistin përgjegjës të Shërbimit të Provës brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit. Në rast se ai nuk paraqitet brenda afatit të caktuar, i dërgohet një njoftim i dytë të nesërmen e përfundimit të afatit nëpërmjet punonjësit të policisë, kompetent për territorin, dhe shërbimit të Policisë Gjyqësore.

2. Në rast se edhe pas njoftimit të dytë sipas 1 të këtij neni, personi nuk gjendet, specialisti i Shërbimit të Provës harton dhe i paraqet prokurorit raport mospërmbushje.

3. Specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen e të miturit nën mbikëqyrje, i realizon njoftimet sipas këtij neni nëpërmjet kujdestarit ose përfaqësuesit të tij ligjor të përcaktuar në vendimin gjyqësor.

4. Specialisti i Shërbimit të Provës vlerëson arsyet e dokumentuara, që kanë penguar vendosjen e kontaktit nga personi nën mbikëqyrje. Në rastet kur e vlerëson të nevojshme, specialisti i Shërbimit të Provës ka të drejtën të kërkojë konfirmim zyrtar nga institucionet shtetërore ose subjektet private që kanë lëshuar aktin.

5. Specialisti i Shërbimit të Provës në kontaktin e parë me personin nën mbikëqyrje verifikon identitetin e tij dhe e informon në gjuhë të kuptueshme prej tij, për qëllimin dhe objektivat e mbikëqyrjes, për të drejtat dhe garancitë ligjore, për detyrimet e tij sipas vendimit gjyqësor, si dhe për pasojat që rrjedhin nga mospërmbushja e tyre.

6. Në kontaktin e parë, specialisti i Shërbimit të Provës synon të vendosë një marrëdhënie pozitive me personin nën mbikëqyrje, si dhe siguron informacionin e nevojshëm për vlerësimin e situatës ekonomike, sociale, gjendjen shëndetësore, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për vlerësimin paraprak të tij.

7. Veprimet e realizuara gjatë takimit të parë regjistrohen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga specialisti i Shërbimit të Provës dhe personi nën mbikëqyrje. Kur ai është i mitur, procesverbali nënshkruhet edhe nga kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor.

Neni 23

Plani individual i trajtimit

1. Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e personit nën mbikëqyrje, me qëllim qartësimin e nevojave për mungesat fizike, afektive ose shoqërore, vullnetit të tij për punë dhe aftësitë e tij profesionale. Shërbimi i Provës, bazuar në këtë vlerësim, në të dhënat personale, familjare e shoqërore, si dhe në masën e dënimit, harton planin individual të trajtimit të personit nën mbikëqyrje në përputhje me dënimin alternativ përkatës. Ky plan miratohet nga drejtori i degës territoriale përkatëse.

2. Plani individual i trajtimit diskutohet me personin nën mbikëqyrje. Ky plan mund të ndryshohet në varësi të ecurisë së tij.

3. Plani individual i trajtimit nënshkruhet nga specialisti i Shërbimit të Provës dhe personi nën mbikëqyrje dhe, kur ky është i mitur, nënshkruhet nga kujdestari i tij ligjor dhe mbrojtësi i tij. Një kopje e planit individual i dorëzohet personit nën mbikëqyrje, kujdestarit të tij ligjor, kur ky është i mitur, dhe mbrojtësit.

4. Kur gjykata vendos detyrimin e personit nën mbikëqyrje për të marrë pjesë në një program rehabilitimi, plani individual i trajtimit përshkruan përmbajtjen, kohëzgjatjen dhe mënyrën e kryerjes së tij.

5. Kur gjykata vendos detyrimin e kryerjes së një pune të papaguar në interes publik, programi individual i mbikëqyrjes përmban përshkrimin e punës, vendndodhjen dhe kohëzgjatjen e saj.

6. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës mban kontakte të vazhdueshme me personin nën mbikëqyrje gjatë gjithë periudhës së vënies në provë. Specialisti i Shërbimit të Provës dhe personi nën mbikëqyrje bien dakord dhe nënshkruajnë programin e realizimit të mbikëqyrjes.

7. Rregullat e detajuara për të dhënat që përmban plani individual i trajtimit dhe mënyrën e hartimit të tij përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

Neni 24

Administrimi i të dhënave gjatë mbikëqyrjes së dënimeve alternative

1. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës krijon dosje personale të shërbimit të provës për çdo person nën mbikëqyrje, ku administrohen të gjitha aktet e nxjerra nga Shërbimi i Provës gjatë procesit penal dhe ekzekutimit të vendimit gjyqësor përkatës.

2. Dosja personale e shërbimit të provës dhe përmbajtja e saj, pas përfundimit të periudhës së provës, trajtohet në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

3. Çdo degë territoriale e Shërbimit të Provës, në përmbushje të detyrave funksionale, mban në formë shkresore regjistrat e mëposhtëm:

a) regjistrin e personave nën mbikëqyrje;

b) regjistrin e kërkesë-ankesave;

c) regjistrin e shkeljeve dhe mospërmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor;

ç) regjistrin e organizatave jofitimprurëse, të institucioneve shtetërore ose subjekteve private, që ofrojnë këshillim dhe asistencë të çdo forme për të dënuarit me alternativa të dënimit me burgim.

d) regjistrin për raportet e vlerësimit të kërkuara nga gjykata ose prokuroria.

4. Të drejtën për t'u konsultuar me përmbajtjen e dosjes personale të shërbimit të provës gjatë mbikëqyrjes e kanë personi nën mbikëqyrje ose kujdestari i tij ligjor, mbrojtësi, gjyqtari dhe prokurori.

5. Format, përmbajtja dhe mënyrat e krijimit dhe të administrimit të regjistrave, të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

6. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale, të administruara në dosjet personale të Shërbimit të Provës dhe i të dhënave që ndodhen në regjistrat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, trajtohen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Veprimet që kryhen në zbatim të vendimeve të parashikuara në kuadër të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur

1. Në kuadër të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Shërbimi i Provës mbikëqyr zbatimin e vendimeve gjyqësore për:

- a) masën e shmangies nga ndjekja penale;
- b) dënimet jo me burgim.

2. Shërbimi i Provës udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të të miturit dhe i ofron të miturit ndihmë sociale, edukative, arsimore, psikologjike, mjekësore dhe fizike në përshtatje me nevojat individuale dhe në përputhje me grupmoshën, gjininë dhe personalitetin e tij, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në jetën shoqërore.

3. Veprimet që kryhen nga Shërbimi i Provës për efekt të mbikëqyrjes së vendimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni janë si më poshtë:

- a) verifikimi dhe përcaktimi i kompetencës territoriale;
- b) vendosja e kontaktit të parë me të miturin, i cili duhet të zhvillohet menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se 7 ditë nga marrja e kërkesës nga gjykata apo prokurori, në prani të mbrojtësit, prindit ose kujdestarit të tij ligjor dhe psikologut;
- c) informimi për të drejtat dhe detyrimet që i mituri gëzon gjatë procesit të mbikëqyrjes;
- ç) analizimi i sjelljes së të miturit, personalitetit, kushteve familjare, natyrës së veprës penale të kryer prej tij dhe rrethanave të tjera, me qëllim hartimin e planit individual të trajtimit në bashkëpunim me të miturin, prindin ose kujdestarin e tij ligjor dhe strukturat e mbrojtjes së të miturit.

4. Shërbimi i Provës mbikëqyr përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve, që burojnë nga masa e shmangies nga ndjekja penale dhe dënimeve jo me burgim. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, të parashikuara në këto vendime, Shërbimi i Provës njofton menjëherë me shkrim prokurorin duke i vënë në dispozicion raportin e vlerësimit për kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërmbushjes, si dhe situatën personale të të miturit.

5. Shërbimi i Provës njofton njëkohësisht të miturin, kujdestarin tij ligjor dhe mbrojtësin për pasojat e moszbatimit të detyrimeve dhe rregullat e shqyrtimit në rast mospërmbushjeje.

6. Rregullat e detajuara për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

7. Format i raportit, i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Detyrimet e personit nën mbikëqyrje në rast të ndryshimit të vendbanimit

1. Personi nën mbikëqyrje është i detyruar të njoftojë me shkrim dhe të marrë pëlqimin nga specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës për ndryshimin e vendbanimit apo vendqëndrimin, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit duke paraqitur dokumentacionin përkatës. Shërbimi i Provës jep ose refuzon në mënyrë të arsyetuar dhënien e pëlqimit pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës.

2. Në raste urgjente, njoftimi për marrjen e pëlqimit, si dhe dhënia ose refuzimi i pëlqimit nga Shërbimi i Provës mund të bëhet edhe nëpërmjet telefonit ose postës elektronike. Në çdo rast personi nën mbikëqyrje dërgon me shkrim brenda 3 ditëve adresën e vendit ku do të qëndrojë dhe dokumentacionin përkatës që vërteton ndryshimin e vendbanimit, vendqëndrimit, qendrës së punës apo lëvizjen e kryer brenda vendit.

3. Në rastin e dënimit me qëndrim në shtëpi, procedurat për ndryshimin e vendbanimit apo të vendqëndrimit rregullohen sipas përcaktimeve të bëra nga legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.

4. Nëse vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit ndodhet në një zonë jashtë kompetencës tokësore të degës territoriale të Shërbimit të Provës të ngarkuar fillimisht me mbikëqyrjen, kjo e fundit i dërgon degës territoriale të Shërbimit të Provës, në kompetencën tokësore të së cilës gjendet vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit nën mbikëqyrje, dosjen personale të shërbimit të provës.

5. Specialisti përgjegjës për mbikëqyrjen njofton për ndryshimin e vendbanimit, vendqëndrimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit organet vendore të Policisë së Shtetit dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit brenda tre ditëve.

6. Rregullat e detajuara për rastet e ndryshimit të vendbanimit, vendqëndrimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit dhe për mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 27

Mbështetja për personin nën mbikëqyrje

1. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës ndihmon dhe mbështet personin nën mbikëqyrje për riintegrimin e tij në shoqëri, duke e referuar atë pranë institucioneve dhe strukturave shtetërore kompetente për punësimin, strehimin, formimin profesional dhe strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në informacionin e administruar gjatë të gjithë procesit dhe vlerësimin e personalitetit dhe të mjedisit shoqëror të personit nën mbikëqyrje. Për të miturit në konflikt me ligjin, specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës ofron gjithashtu mbështetje për ndjekjen e arsimit përkatës nga i mituri.

2. Mbështetja dhe ndihma që i ofrohet personit nën mbikëqyrje gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes konsiston në ndërhyrje të specializuara në përshtatje me nevojat e tij, me qëllim shmangien e rrezikut të kryerjes së veprave të reja penale ose për normalizimin e marrëdhënieve më viktimën dhe familjarët e saj.

3. Pas përfundimit të periudhës së vënies në provë, personi nën mbikëqyrje nuk ka detyrim të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, me përjashtim të rastit kur kërkohet vetë prej tij. Në këto raste, Shërbimi i Provës ua referon rastin strukturave përgjegjëse të shërbimeve sociale të njësisë të vetëqeverisjes vendore, si dhe ofron këshillimin e nevojshëm ndaj personit nën mbikëqyrje me pëlqimin e tij.

4. Personat nën mbikëqyrje me shtetësi të huaj ose pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh gjendjen dhe nevojat e tyre specifike. Specialistët e Shërbimit të Provës ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike, me të cilat këta persona mund të përballen pas përfundimit të periudhës së vënies në provë.

5. Rregullat dhe procedurat e detajuara për mbështetjen dhe asistencën që ofrohet për personat nën mbikëqyrje nga specialisti i Shërbimit të Provës përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 28

Mbështetja për viktimën

1. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës mbikëqyr zbatimin e detyrimeve për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga vepra penale e kryer nga personi nën mbikëqyrje.

2. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës bashkëpunon me ndërmjetësues të licencuar, nisur nga referimi i rasteve dhe trajtimi i tyre përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

3. Në rastin kur personi nën mbikëqyrje është i mitur, procedura e parashikuara në pikën 2 të këtij neni mund të zbatohet vetëm me pëlqimin e të miturit, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

4. Specialisti i Shërbimit të Provës merr masat e nevojshme që procesi i ndërmjetësimit të zhvillohet me pjesëmarrjen personale të të miturit, kujdestarit të tij ligjor, psikologut dhe viktimës. Në procesin e ndërmjetësimit, me pëlqimin e palëve, mund të marrin pjesë punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij.

5. Çdo veprim i kryer gjatë procesit të ndërmjetësimit dokumentohet me procesverbal. Specialisti i Shërbimit të Provës kujdeset që ky procesverbal të bëhet pjesë e dosjes personale të shërbimit të provës të personit nën mbikëqyrje.

6. Specialisti i Shërbimit të Provës ruan konfidencialitetin e informacionit për të cilin merr dijëni gjatë procesit të ndërmjetësimit, me përjashtim të rasteve kur informacioni shërben për parandalimin e një veprë penale.

Neni 29

Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara nga gjykata

1. Kur specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës konstaton se personi nën mbikëqyrje ka shkelur kushtet dhe detyrimet që i janë vendosur nga gjykata, ka detyrimin të verifikojë rrethanat dhe shkaqet penguese dhe të njoftojë prokurorin.

2. Kur institucionet shtetërore apo subjektet private konstatojnë mospërmbushje të detyrimeve përkatëse nga personi nën mbikëqyrje, brenda 5 ditëve i raportojnë Shërbimit të Provës, i cili njofton prokurorin.

3. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës harton raport për mospërmbushjen e detyrimeve të vendosura nga gjykata, i cili përmban informacion për rrethanat e mospërmbushjes, shpjegimet e dhëna nga personi nën mbikëqyrje, vlerësimin që Shërbimi i Provës i ka bërë rasti dhe rekomandim për veprimet që duhen ndërmarrë, në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë së shkeljes. Ky raport i dërgohet menjëherë prokurorit.

4. Rregullat e detajuara për trajtimin e rasteve të mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e personit nën mbikëqyrje përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 30

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

1. Shërbimi i Provës, në zbatim të rregullave të Konventës Europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht apo rregullave të përcaktuara në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim.

2. Procedurat e bashkëpunimit, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 31

Bashkëpunimi me institucione shtetërore, subjekte private dhe organizata të shoqërisë civile

1. Shërbimi i Provës bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit gjatë pranimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të rrezikshmërisë së personave nën mbikëqyrje.

2. Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organe të tjera, që ofrojnë shërbime për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave nën mbikëqyrje.

3. Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë për kërkime dhe studime, me qëllim përmirësimin e praktikave të punës me personat nën mbikëqyrje.

4. Shërbimi i Provës bashkëpunon me subjekte private, organizata të shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, që punojnë në fushën e të drejtave të të dënuarve dhe shërbimeve në komunitet, me qëllim promovimin e riintegritimit në shoqëri të personave nën mbikëqyrje.

Neni 32

Inspektimi

1. Veprimtaria e specialistëve të Shërbimit të Provës për respektimin e parashikimeve të këtij ligji është objekt inspektimi nga struktura përgjegjëse për inspektimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe nga Ministria e Drejtësisë.

2. Pas përfundimit të inspektimit, personat e autorizuar për kryerjen e inspektimeve përgatisin rekomandimet, sipas rastit, për ministrin e Drejtësisë, drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ose Drejtorin e Degëve Territoriale për marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara.

3. Rregullat e detajuara për kryerjen e inspektimeve, të drejtat dhe detyrat e inspektorëve dhe subjekteve të inspektuara përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 33

Ankimi administrativ dhe gjyqësor

1. Personi nën mbikëqyrje ka të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor kundër veprimeve të specialistit të Shërbimit të Provës, të caktuar me mbikëqyrjen e tij.

2. Ankimi administrativ paraqitet fillimisht pranë drejtorit të degës territoriale ku ushtron detyrën specialisti i Shërbimit të Provës dhe më pas pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

3. Ankimi administrativ shqyrtohet brenda 14 ditëve nga paraqitja, përveç rasteve kur ky ligj parashikon afate të posaçme, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

4. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës personi nën mbikëqyrje ka të drejtën e ankimit te prokurori ose në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale dhe legjislacionit në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34

Dispozita kalimtare

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëpunësit aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale të Shërbimit të Provës, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, vijojnë të ruajnë pozicionet e tyre me të njëjtat kushte sikurse janë punësuar më parë në Drejtorinë e Përgjithshme të Provës dhe në Degët Territoriale, nëse plotësojnë kriteret e punësimit të parashikuara në këtë ligj.

2. Punonjësit administrativë vazhdojnë të mbeten në detyrë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Procedurat e filluara për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të ndiqen sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 35

Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 18, pika 5; 23, pika 7; 24, pika 5; 25, pika 7, dhe 30, pika 2, të këtij ligji.

Neni 36

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, vendimi nr.302, datë 25.3.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”” shfuqizohet.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 25.6.2020